



Prishtinë, 27.02.2009  
Kodi i ZRRE-së: V\_159\_2009

### Bordi i Zyrës së Rregullatorit për Energji

Duke marrë parasysh:

1. Dispozitat e Neneve 15.2 dhe 25 të Ligjit për Rregullatorin e Energjisë të amendamentuar me Ligjin Nr. 03/L-080;
2. Dispozitat e Nenit 49.2 të Rregullit për Licencimin e Aktiviteteve të Energjisë në Kosovë;
3. Kërkesën e KEK SH.A për derogim në zbatimin e disa dispozitave të Licencave të KEK SH.A-së, të datës 02.02.2009, në seancën e mbajtur më 27 shkurt 2009 nxori këtë:

### VENDIM

#### I. I lejohet KEK Sh.A-së derogimi në zbatimin e disa neneve dhe dispozitave të:

- Licencës për Gjenerim të Energjisë Elektrike TC Kosova A
- Licencës për Gjenerim të Energjisë Elektrike TC Kosova B
- Licencës për Operatorin e Sistemit të Shpërndarjes
- Licencës për Furnizim Publik me Energji Elektrike dhe
- Licencës për Furnizim/Tregti me Energji Elektrike.

1. Të gjitha Nenet dhe dispozitat tjera të licencave të KEK Sh.A-së mbesin në fuqi.
2. Ky Vendim nxirret në tri gjuhë: shqip, serbisht dhe anglisht dhe do të publikohet në faqen elektronike zyrtare të ZRRE-së.
3. Pala e pakënaqur, mund të paraqesë ankesë kundër këtij Vendimi në gjykatën e juridiksionit përkatës, brenda 14 ditësh nga data e lejimit ose datës së publikimit të vendimit në faqen elektronike zyrtare të ZRRE-së.
4. Ky Vendim hyn në fuqi në datën e lëshimit të tij ose në datën e publikimit të tij në faqen elektronike zyrtare të ZRRE-së.



5. Vendimit i bashkëngjitet Shtojca me dispozitat dhe Nenet e deroguara.

**Bordi i ZRRE-së**

---

Dr. Ali Hamiti, kryesues

---

Theranda Beqiri, anëtare

---

Dr. Nysret Avdiu, anëtar

---

Përparim Kabashi, anëtar

---

Blerim Koci, anëtar



Shtojcë: Nenet e deroguara të licencave të KEK SH.A-së

<b>Licenca e Gjenerimit TC Kosova A</b>				
Nr	Neni	Derogimi i datës 15.08.08 deri me:	Derogimi i datës 17.02.09 deri me:	Koment nga ZRRE
1	Neni 2- Llogaritë e Ndara për Bizneset gjeneruese	31 dhjetor 2008	31 mars 2009	Sipas dispozitës 2.1 të Nenit 2 , KEK SH.A duhet të dorëzojë <b>Raportin Financiar të Audituar për vitin 2006 dhe 2007</b> , andaj kjo dispozitë nuk derogohet.
<b>Licenca e Gjenerimit TC Kosova B</b>				
Nr	Neni	Derogimi i datës 15.08.08 deri me:	Derogimi i datës 17.02.09 deri me:	Koment nga ZRRE
1	Neni 2- Llogaritë e Ndara për Bizneset gjeneruese	31 dhjetor 2008	31 mars 2009	Sipas dispozitës 2.1 të Nenit 2 , KEK SH.A duhet të dorëzojë <b>Raportin Financiar të Audituar për vitin 2006 dhe 2007</b> , andaj kjo dispozitë nuk derogohet.
<b>Licenca për Operatorin e Sistemit të Shpërndarjes</b>				
Nr	Neni	Derogimi i datës 15.08.08 deri me:	Derogimi i datës 17.02.09 deri me:	Koment nga ZRRE
1	Neni 2- Llogaritë e Ndara për Bizneset e Operatorit të Shpërndarjes	31 dhjetor 2008	31 mars 2009	Sipas dispozitës 2.1 të Nenit 2 , KEK SH.A duhet të dorëzojë <b>Raportin Financiar të Audituar për vitin 2006 dhe 2007</b> , andaj kjo dispozitë nuk derogohet.
2	Neni 11-Standardet e Sigurisë së Sistemit të Shpërndarjes dhe Planifikimit	31 dhjetor 2008	30 qershor 2009	Kërkohet që këto Standarde të punohet si draft deri më së largu me datë 30 qershor 2009.
3	Neni 12 Standardet e Sigurisë së Operimit	31 dhjetor 2008	30 qershor 2009	Kërkohet që këto Standarde të punohet si draft deri më së largu me datë 30 qershor 2009.
4	Neni 13-Standardet e Përgjithshme dhe Minimale të Përbushjes së Bizneseve të Operatorit të Shpërndarjes	31 dhjetor 2008	31 dhjetor 2009	Kërkohet që Grupi Punues i përbërë nga KEK-ZRRE-MEM-KOSTT të finalizojë këto Standarde më së largu deri me 31.12.2009.
5	Neni 18-Kodi I Sjelljes i Operatorit të Sistemit të Shpërndarjes	31 dhjetor 2008	31 mars 2009	Kërkohet që Kodi i Sjelljes i OSSH-së të punohet më së largu deri me 30 mars 2009.

**Licenca për Furnizim Publik me Energji Elektrike**



Nr	Neni	Derogimi i datës 15.08.08 deri me:	Derogimi i datës 17.02.09 deri me:	Koment nga ZRRE
1	Neni 2- Llogaritë e Ndara për Biznesin e Furnizimit Publik	31 dhjetor 2008	31 mars 2009	Sipas dispozitës 2.1 të Nenit 2 , KEK SH.A duhet të dorëzojë <b>Raportin Financiar të Audituar për vitin 2006 dhe 2007</b> , andaj kjo dispozitë nuk derogohet.
2	Neni 8-Standardet e Përgjithshme dhe Minimale të Përbushjes	31 dhjetor 2008	31 dhjetor 2009	Kërkohet që Grupi Punues i përbërë nga KEK-ZRRE-MEM-KOSTT të finalizojë këto Standarde më së largu deri me 31.12.2009.
<b>Licenca për Furnizim/Tregti me Energji Elektrike</b>				
Nr	Neni	Derogimi i datës 15.08.08 deri me:	Derogimi i datës 17.02.09 deri me:	Koment nga ZRRE
1	Neni 2- Llogaritë e Ndara për Biznesin e Furnizim/tregtisë me energji elektrike	31 dhjetor 2008	31 mars 2009	Sipas dispozitës 2.1 të Nenit 2 , KEK SH.A duhet të dorëzojë <b>Raportin Financiar të Audituar për vitin 2006 dhe 2007</b> , andaj kjo dispozitë nuk derogohet.
2	Neni 8-Standardet e Përgjithshme dhe Minimale të Përbushjes	31 dhjetor 2008	31 dhjetor 2009	Kërkohet që Grupi Punues i përbërë nga KEK-ZRRE-MEM-KOSTT të finalizojë këto Standarde më së largu deri me 31.12.2009.